



Prishtinë: 13.06.2017

Kodi i ZRRE-së: V\_991\_2018

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_1782\_03\_18**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **30.04.2018**.

në seancën e mbajtur më datë 13.06.2018, nxori këtë:

### V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin H. Sh, nga Prishtina me shifër të konsumatorit: DPR - 90055310 si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK\_V\_1782\_03\_18 i datës 15.03.2018.

### A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 30.04.2018 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë për këto shkaqe: Përfaqësuesi i KESCO-së, në ankesë ka theksuar se rezultati i shqyrtimit të njehsorit elektrik nr.63891030 kanë theksuar se njehsori elektrik është brenda kufijve të lejuar të matjes dhe se si pasojë e këtij rezultati është bërë faturimi i muajit 11/2014 dhe 12/2014 pa bërë ndonjë korrigjim të mundshëm. Në ankesën e KESCO gjithashtu është theksuar se DMK në ZRRE vendimin e tij e nuk e bazon në raportin e kalibrimit por vetëm nga rrjedha e energjisë elektrike për muajin e njëjtë të vitit paraprakë, pra në shpenzimin e energjisë elektrike para dhe pas periudhës kontestuese. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK\_V\_1782\_03\_18 i datës 15.03.2018 për konsumatorin H. Sh. me shifër DPR - 90055310.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 09.02.2017 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejt dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i ZRRE-së gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka vlerësuar si të bazuara konstatimet e bëra nga shkalla e parë në të cilat theksohet se në periudhën 11/2014 konsumatori i është larguar nga matja njehsori elektrik nr.45813389 me gjendje TL=1,166 kWh dhe TU=4,525 kWh, si dhe i është



vendosur për matje njehsori elektrik nr.63891030 i cili ka qenë i vendosur deri në periudhën 02/2015, kur edhe është larguar nga matja me gjendje të shpenzimeve TL=5,526 kWh dhe TU= 3,394 kWh. Departamenti i faturimit në KEDS me datë 29.11.2014 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën nëntor 2014 me shpenzim prej **5,627 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **569.75€**, si dhe me datë 29.12.2014 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën dhjetor 2014 me shpenzim prej **3,293 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **324.71€**. Bordi i ZRRE-së gjithashtu ka vërejtur se punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse me datë 13.01.2015 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr. 63891030 prej TL=005526 kWh dhe TU=003394 kWh. Pra Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se faturat 11/2014 dhe 12/2014 të larta i kanë shkuar konsumatorit menjëherë me vendosjen e njehsorit elektrik nr.63891030, e cila ka ndodhur në periudhën 11/2014.

Bordi i ZRRE-së ka theksuar punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse me datë 14.05.2016 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr.63980511 prej TL=000530 kWh dhe TU=000161 kWh, dhe se shpenzimet e energjisë elektrike të evidentuara në procesverbalin e inspektimit të lartcekur përputhen me gjendjen e shpenzimit të energjisë elektrike të evidentuar në rrjedhën e energjisë elektrike “CCP” për periudhën prill 2016.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe protokollin e shqyrtimit të njehsorit elektrik nr.org. 02 nr. 5441 i datës 12.04.2016, të cekur në ankesën e KESCO, e në të cilin protokoll është konstatuar se *“Njehsori elektrik është në rregull, njehsori elektrik ka blloibat shtetërore, nga ana e jashtme njehsori dëmtime nuk ka si dhe kanë konstatuar se gabimi në matje është +0.27%”*. Pra, Bordi i ZRRE-së thekson se bazuar në të gjeturat përkatësisht shqyrtimin e saktësisë së matjes nga qendra e kalibrimit për njehsorin elektrik nr.63891030 konstatohet se gabimi në matje është brenda kufijve të lejuar matës.

Sa i përket pikës së kundërshtimit se nuk duhet të merret parasysh krahasimi i shpenzimit të energjisë elektrike kjo nuk qëndron sepse shpenzimi i energjisë elektrike është indikacion mjaft i rëndësishëm në shqyrtimin e lëndëve të konsumatorit. Bordi i ZRRE-së ka analizuar me kujdes shpenzimin e energjisë elektrike dhe konstaton se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve të energjisë elektrike. Lidhur me këtë Bordi i ZRRE-së ka bërë krahasimin e shpenzimeve për periudhën kontestuese me periudhat e njëjta të më hershme dhe të mëvonshme me tre njehsorët elektrik, njehsorin elektrik nr.45813389, njehsorin kontestues nr.63891030, si dhe njehsorin e ri elektrik nr.63980511 dhe vërteton se konsumatori ka ndryshim në shpenzimin e energjisë elektrike. Sipas rrjedhës se energjisë elektrike shpenzimi i konsumatorit per periudhat e me hershme me njehsorin elektrik nr. 45813389: periudha 11/2013 është **31 kWh**, periudha 12/2013 është **30 kWh**, periudha 11/2012 është **71 kWh**, periudha 12/2012 është **67 kWh**, 11/2011 është **13 kWh** dhe 12/2011 është **15 kWh**; kurse për periudha të mëvonshme me njehsorin e ri elektrik nr. 63980511: periudha 11/2015 është **10 kWh**, 12/2015 është **2 kWh**, periudha 11/2016 është **42 kWh**, periudha 12/2016 është **30 kWh**, si dhe periudha 11/2017 është **27 kWh** dhe **12/2017** është **33 kWh**. Gjithashtu Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe shpenzimin e përgjithshëm të energjisë elektrike të konsumatorit dhe ka vërejtur se shpenzimi i përgjithshëm i konsumatorit prej periudhës 02/2015 e deri më 02/2018 nuk përputhet me shpenzimin e faturuar mujor të periudhave kontestuese 11/2014 dhe 12/2014. Bordi i ZRRE-së bazuar në analizat e bëra konstaton se konsumatori në periudha kontestuese 11/2014 dhe 12/2014 nuk është faturuar me shpenzimet reale për shkak se shpenzimet e mëhershme si dhe të më vonshme me njehsorët elektrik nr.45813389 dhe nr.63980511 vërtetojnë se konsumatori ka shpenzim shumë të ulët dhe se këto shpenzime nuk përputhen me shpenzimet e faturuara për periudhat 11/2014 dhe 12/2014.



Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejt dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 09.02.2017 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

\_\_\_\_\_  
Arsim Janova, u.d. kryesues

\_\_\_\_\_  
Besim Sejfiqaj, anëtar

\_\_\_\_\_  
Selman Hoti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit H.Sh., dhe
- Arkivit të ZRRE-së.